

PA DEMOKRACI



NUK KA DRITË

DEMOKRACIA, SISTEM I BARAZISË

SUNA (11), TEA (12), VELI (12), BLODI (12), RREZON (11), ILIRIDA (11), LEDI (11), ERION (11), LEKA (11)



Nuk ka lumturi dhe gëzim më të madh sesa fëmijët të flasin dhe të shkruajnë për fëmijët e tjerë rreth demokracisë dhe rëndësisë së saj

Demokracia është sistem, në të cilin jo vetëm fëmijët, por të gjithë qytetarët trajtohen në mënyrë të barabartë. Kur e përmendëm fjalën „trajtim i barabartë“, ishte shoku ynë Ledi ai i cili na tregoi sesa është e rëndësishme kjo fjalë. Pas saj, fshihen shumë mrekulli të tjera.

Trajtim në mënyrë të barabartë do të thotë: kujdes, dashamirësi, respekt dhe tolerancë ndaj njëri-tjetrit. Sipas neve, është për t'u vlerësuar lart kjo mënyrë e sjelljes. Kjo sepse jo të gjithë qytetarët ia dinë vlerën dhe rëndësinë e kësaj fjale. Ka qytetarë që aspak nuk trajtohen mirë dhe nuk kanë të drejtë t'i gëzojnë liritë e tyre. Kjo ndodh tek vendet, të cilat nuk kanë udhëheqje demokratike. Në ato shtete, ne nuk e besojmë që përdoret fjala barazi apo thënë më mirë trajtimi në mënyrë të barabartë. Ka qytetarë të cilët aktualisht gëzojnë shumë të drejta. Kjo normalisht është e mirë, sepse vetëm në këtë mënyrë arrihet mirëqenie sociale për të gjithë.

Ne qytetarët, po ashtu duhet të jemi të përgjegjshëm ndaj njëri-tjetrit. Duhet të mos bëjmë dallime mes njëri-tjetrit, sepse këto dallime nuk na sjellin dobi. Të gjitha këto që i cekëm më lart, më parë mund të themi se ishin më shumë të pranishme, duke iu referuar kështu kohës kur është shfaqur demokracia. Aso kohe


kishe shumë dallime dhe pa barazi, sidomos ishin gjinia femërore dhe qytetarët e varfër ata të cilët ishin shumë të diskriminuar. „Cila ishte ajo kohë?“ pyeti Ilirida. Ishte viti 507 para lindjes së Krishtit, kur këto dallime ishin shumë të dukshme, edhe pse ishte koha e lindjes dhe kur demokracia veçse filloi të lulëzonte. „Sa mirë që paska ndryshuar demokracia“ tha Suna, „sepse po të ishte e njëjta sot, vështirë që do të pajtoheshja me të“. Ne e duam këtë sistem, sepse na mundëson lirinë e fjalës, të arsimit, të strehimit, të argëtimit, etj. E duam sepse ky sistem është vetë jeta jonë. Për këtë e duam dhe e respektojmë edhe vendin tonë, sepse ne mund të jetojmë me të gjitha këto të drejta që i përmendëm më lart. Vendi ynë ka demokraci përfaqësuese. Ne si qytetarë jemi ata të cilët i zgjedhim udhëheqësit e vendit tanë. Kjo është e drejtë shumë e dashur për ne. Faleminderit që zgjodhët të informoheshit nga ne.



Autorët e artikullit

MENDIMET E LIRA, VOTA E LIRË

SHEGA (11), POEMA (11), ZANI (11), MERITON (11), DORA (11), VERONA (11), SAMED (12), FIONA (11),
ERRIS (11), DION (11)




Artikulli ynë flet për procesin zgjedhor. Ai flet sesa e rëndësishme është që të gjithë ne të marrim pjesë në këtë proces

Na ishte një herë një qytetar i cili quhej Fredi. Ai që i vogël ëndërronte të bëhej deputet. Meqë miku ynë

realizonte ëndrrën e tij, kësaj radhe. Kjo për shkak të një vote të vetme. Për vetëm një votë, Fredi nuk arriti të grumbullonte votat e nevojshme. Andaj, edhe nuk u bë deputet.

Të dashur lexues, po përpiqemi t'iu tregojmë se vota e të gjithë neve vlen. Ne duhet të marrim pjesë në procesin zgjedhor me mendimin se një votë e jona mund të bëj ndryshimin.

Ne në Kosovë kemi dy lloje të zgjedhjeve. Janë zgjedhjet qendrore ku votojmë për deputetët, si dhe zgjedhjet komunale, ku votojmë për kryetarët e komunave përkatëse dhe asamblistët. Si qytetarë, ne duhet të jemi të kujdesshëm se kë zgjedhim të votojmë. Prandaj, duhet të jemi mbi moshën 18 vjeçare për të marrë pjesë në këtë proces demokratik. Me zgjedhjen të cilën e bëjmë, ne vendosim kush do të na përfaqësoj.



Fredi jeton në një vend demokratik dhe ka arritur moshën 18 vjeçare, ai ka të drejtë që të realizoj ëndrrën e tij të kahmotshme. Tashmë është koha e zgjedhjeve dhe Fredi është kandidat për deputet në Kuvendin e Kosovës. Mirëpo, qytetarët e Kosovës janë ata të cilët e marrin vendimin në këtë rast. Fredit i nevojiten shumë vota të qytetarëve në këto zgjedhje për t'u futur në radhët e deputetëve të Kosovës.


E dini se çfarë i ndodhi mikut tonë? Sado që kishte dëshirë të bëhej deputet dhe kishte hartuar planprogram shumë të mirë për vendin tonë, ai nuk arriti ta



Ne e shkruam këtë artikull



Bashkëpunuam për të arritur sukses



Ne kemi vendosur që të jemi Dielli, i cili ndriçon dhe ndikon që demokracia të rritet e të lulëzoj, si një lule



Këtu jemi ne nxënësit e klasës VI-2 nga shkolla „Fehmi Agani“ gjatë vizitës në institucionin më demokratik, Kuvendin tonë

TË DREJTAT TONA, TË GARANTUARA ME LIGJ

ENSAR (11), OLTİ B. (11), OLTİ J. (11), ADOLF (12), DREN (11), ARTILA (11), FIONA D. (11), LEA K. (12),
LEA B. (11)




Pse është e rëndësishme të dijmë rreth Kuvendit? Çfarë bëhet në këtë institucion dhe sa shumë ndikon në jetën tonë si fëmijë?

Kuvendi është institucioni më demokratik i vendit. Deputetët të cilët punojnë aty janë përfaqësuesit e popullit. Numri i tyre në Kuvendin e Republikës së Kosovës është 120. Prej tyre, 100 janë të kombit shqiptar dhe 20 të tjerë të komuniteteve jo shumicë. Ligjet të cilat janë rregulla që ne duhet t'i zbatojmë dhe t'i respektojmë, miratohen apo nuk miratohen pikërisht në Kuvend. Prandaj, është institucion shumë i rëndësishëm për jetën tonë. Kuvendi ndryshe njihet edhe si „vendi i ligjeve“. Po ashtu, puna e Kryeministrit dhe ministrave kontrollohet nga deputetët. Për shembull, nëse një deputet dëshiron të dijë ndonjë çështje rreth arsimit në Kosovë, ai mund t'i bëjë pyetje Ministrit të Arsimit, i cili e ka obligim t'i u përgjigjet atyre pyetjeve.

Disa shembuj nga jeta jonë për ligjet dhe zbatimin e tyre

Vesa është nxënëse në klasën e VI-të dhe gjithmonë është interesuar për ligjet, të drejtat e njeriut dhe lirinë. Ajo kur shkon në shkollë i respekton shoqet, shokët dhe mësuesen, sepse është vajzë shumë e përgjegjshme për veprimet e saj. Një ditë prej ditësh, ajo po shkonte në shkollë, ku po kalonin shumë makina, por me shpejtësi të ulët. Ajo ishte shumë kurioze të dinte se pse po ndodhte kjo gjë. Pasi e mbaroi orarin mësimor, iu tregoi familjarëve të saj për shpejtësinë e veturave dhe i pyeti ata: „Pse të gjitha veturat kalonin me shpejtësi të ulët?“ Familjarët u përgjigjën: „Sepse rregullat e komunikacionet e përcaktojnë shpejtësinë e lejuar të veturave. Rregullat e tilla janë vendosur për të mirën tonë“. Prandaj, të gjithë duhet të respektojmë ato.



Disa fakte rreth Kuvendit



Gazetarët e vegjël nga Gjakova



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Fehmi Agani“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VI-1
Website: www.demos-ti.org Vendi: Gjakovë